
THE IMPACT OF FEEDBACK STRATEGY ON FORMATIVE ASSESSMENT OF STUDENTS IN GRADES 1-5

Nazlije Latifaj

South East European University, North Macedonia, n128330@seeu.edu.mk

Arafat Shabani

South East European University, North Macedonia, a.shabani@seeu.edu.mk

Abstract: In some parts of the world, formative assessment and the use of feedback have been implemented early on, leading to more effective learning outcomes for students. Students receive timely and continuous information about their strengths and weaknesses, as well as the need for improvement in their activities and tasks. Feedback is a highly important strategy in teaching and learning, especially in elementary education for grades 1-5. Initially, feedback establishes a respectful communication relationship between students and teachers. Through proper communication, teachers serve as models and motivators for students to freely express their thoughts and ideas. Creating a positive classroom atmosphere indicates a productive and quality learning process. Teachers act as motivators and role models to foster collaboration, learning, and the development of students' learning abilities and skills. During the teaching process, effective communication and the way ideas are transmitted between teachers and students are crucial. Thus, teachers play a pivotal role in encouraging students to share their thoughts, questions, ideas, and observations through feedback, fostering an open dialogue to better understand and meet their needs. In Kosovo, the education system underwent reforms with the introduction of the pre-university education curriculum, which led to changes and enrichment of processes and components to enhance the quality and suitability for students. In this context, formative assessment or assessment for learning was promoted as continuous evaluation for student learning. This type of assessment has its methods and strategies to be implemented in the classroom, and therefore, this study focused on feedback strategies and their impact on student learning. This research involves the collection and analysis of data gathered from the control and experimental groups. The control group comprises students who do not receive formative assessment from their teachers, while the experimental group includes students who receive formative assessment with the intervention of feedback strategies during instruction. The purpose of this study is to analyze the role and significance of feedback in the teaching and learning process of elementary students in grades 1-5. The findings of this research have shown that formative assessment is one of the best assessments as perceived by students, and the types of strategies involved in this assessment yield continuous and better results for students. We examined only one form of formative assessment, feedback, as an effective and beneficial strategy for students, teachers, and overall teaching activity. This type of assessment belongs to the 21st century and is driven by various factors geared towards progress.

Keywords: formative assessment, feedback, students, elementary school, teachers.

NDIKIMI I STRATEGJISË SË FEEDBACK-UT NË VLERËSIMIN FORMATIV TE NXËNËSIT E KLASAVE 1-5

Nazlije Latifaj

Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriut, n128330@seeu.edu.mk

Arafat Shabani

Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriuta, a.shabani@seeu.edu.mk

Abstrakt: Në disa vende të botës, vlerësimi formativ dhe përdorimi i informatës kthyesë ka filluar të përdoret qysh më herët dhe nxënësit janë treguar më efektiv gjatë të nxëniet e tyre. Nxënësit janë informuar me kohë dhe në mënyrë të vazhduar për rezultatet e tyre, për pikat e forta dhe të dobëta si dhe për nevojën e përmirësimit të aktivitetit apo detyrës që realizojnë. Informata kthyesë është një strategji tejet e rëndësishme në mësimdhënie dhe nxënie në arsimin fillor të klasave 1-5. Fillimisht, informata kthyesë apo feedback-u tregon një marrëdhënie të denjë komunikimi në mes nxënësve dhe mësuesit. Përmes komunikimit të duhur, mësuesi jep model dhe motivim për nxënësit që ata të ndjehen të lirë për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre. Krijimi i një atmosfere pozitive në klasë tregon një proces mësimor punues dhe cilësor. Mësuesi është motivuesi dhe modeli që nxënësit të bashkëpunojnë, mësojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe shkathtësitë e tyre mësimore. Gjatë zhvillimit të procesit mësimor, është tejet e rëndësishme komunikimi dhe mënyra e transmetimit të ideve dhe mendimeve të mësuesit dhe nxënësit gjatë të ndërvepruarit. Andaj, mësuesi është ai që përmes informatës kthyesë apo feedback-ut inkurajon nxënësit të shprehin

mendimet, pyetjet, idetë, vërejtjet që kanë për të krijuar një dialog të hapur për të kuptuar dhe ndihmuar më shumë në nevojat e tyre. Ndërkaq në Kosovë, sistemi arsimor filloi reformimin në arsim me ardhjen e kurrikulës së arsimit parauniversitar që si rrjedhojë u ndryshuan dhe pasuruan shumë procese dhe komponente për zhvillimin më cilësor dhe të përshtatshëm për nxënësit. Në këtë rast edhe vlerësimi për të nxënë apo vlerësimi formativ si një ndër komponentet më të rëndësishme u promovua si një vlerësim i vazhdueshëm për të nxënësit e nxënësve. Andaj, ky lloj vlerësimi ka mënyrat dhe strategjitë e saja për t'u realizuar në klasë, dhe si rrjedhojë në këtë studim ne u fokusuar në strategjinë e informatës kthyesë dhe ndikimin e saj që ka gjatë të nxënësit të nxënësve. Ky punim përfshin grumbullimin dhe analizën e të dhënave të realizuara përmes grupit të kontrollit dhe grupit eksperimental. Grupi i kontrollit që përfshin nxënësit të cilët nuk përdoret vlerësimi formativ nga ana e mësuesit, dhe grupi eksperimental që përfshin nxënësit tek të cilët përdoret vlerësimi formativ me ndërhyrje të strategjisë së feedback-ut gjatë realizimit të mësimdhënies. Pra, qëllimi i këtij punimi është të analizojë rolin dhe rëndësinë e informatës kthyesë apo feedback-ut gjatë mësimnxënies së nxënësve të arsimit fillor, klasave 1-5. Gjetjet e këtij hulumtimi kanë treguar që vlerësimi formativ është një ndër vlerësimet më të mirë se ardhura nga ana e nxënësve, dhe llojet e strategjive që përfshijnë ky vlerësim përmbledhin rezultate të vazhdueshme më të mira për nxënësit. Ne studiuam vetëm njërin prej strategjive të vlerësimit formativ, informatën kthyesë apo feedback, si një strategji efektive dhe dobiprurëse për nxënësit, mësuesin dhe tërë veprimtarinë mësimore. Ky lloj vlerësimi i takon shekullit të 21-të dhe varet nga shumë gjëra të cilat janë të orientuara kah përparimi.

Fjalët kyçe: vlerësimi formativ, feedback-u, nxënësit, arsimit fillor, mësimdhënësit.

1. HYRJE

Në arsimin fillor është tejet e rëndësishme komunikimi dhe bashkëpunimi me nxënësit të cilët janë të një moshe më të vogël, andaj kur jemi tek vlerësimi duhet pasur një kujdes të shtuar me fëmijët. Vlerësimi i nxënësve është kompleks dhe shumëdimensional, Andaj, mësuesi haset me disa probleme, dilema dhe vështirësi gjatë kësaj komponente, por edhe ai duhet trajnuar dhe motivuar për të zhvilluar të nxënësit në mënyrë cilësore, duke organizuar dhe planifikuar mësimdhënien me qëllim të të nxënësit (EU4K, 2020). Por, vlerësimi formues është vlerësim i hapur dhe i vazhduar që lejon nxënësit të krijojnë vetëbesim dhe të reflektojnë çdo ditë. Prashanti dhe Ramnaraya (2019) theksojnë që mësuesi duhet të zbatojnë në mënyrë efektive vlerësimin formativ për të transformuar një kulturë frytdhënëse dhe një qasje ndërvepruese në mes trekëndëshit pedagogjik. Vlerësimi formativ ndryshe njihet edhe me konceptet, si: vlerësimi për të nxënë dhe vlerësimi i vazhduar që sipas këtyre koncepteve ky lloj vlerësimi “synon të përkrahë nxënësit të arrijnë kompetencat kryesore duke iu treguar se ku janë sa i përket rezultateve mësimore të parapara. Bazohet në atë që t'i vetëdijësojë nxënësit dhe t'i bëjë pjesëmarrës në përcaktimin e rezultateve mësimore, kritereve të cilësisë dhe treguesve personale të suksesit. Nxënësit mësojnë se çka duhet të bëjnë që të arrijnë ato rezultate të vendosura mësimore dhe si të arrihet atje” (MASHt, 2011, f.65). Nga këto terme dallojmë që ky lloj vlerësimi është tejet i rëndësishëm në veprimtarinë mësimore ngaqë nxënësi, mësuesi dhe mësuesi e përbëjnë atë vlerësim të rëndësishëm dhe reflektues gjatë tërë kohës. Ky lloj vlerësimi formues ndihmon mësuesit të zbulojnë se çfarë nuk kuptojnë nxënësit, çfarë aftësish u mungojnë dhe cilat standarde nuk i kanë arritur. Mësuesit janë ata që duhet ta rregullojnë mësimin dhe mësimdhënien në mënyrë të duhur (William, 2014). Vlerësimi formativ është vlerësim që ndodh gjatë gjithë kohës dhe lejon mësuesin të përdor strategji apo metoda vlerësuese të ndryshme për ndërveprimin e mësimin me nxënësit. Disa prej strategjive janë: qëllimet e të nxënësit, kriteret e suksesit, vetëvlerësimi, “informata kthyesë” në të cilën u fokusua punimi. Këto strategji fillohen të zbatohen qysh në fillimet e viteve të para në arsimin fillor dhe përvetësohen me kohën, gjatë zhvillimit të nxënësve dhe mbështetjen nga mësuesi për arritjen e qëllimeve dhe kritereve të suksesit për të mësuar (Magbeyi et al, 2020).

Feedback-u apo informata kthyesë është jetike në vlerësimin formues, kur ajo jepet në mënyrë efektive dhe në kohën e duhur të nxënësit e arsimit fillor. Reagimet duhet të jenë të mira dhe të ndërlydhura me kriteret e qarta në lidhje me pritshmëritë për performancën e nxënësve, duke e bërë procesin mësimor më transparent dhe duke modeluar aftësinë “të mësuarit për të mësuar” për nxënësit (OECD, 2008). Kështu, sipas Irons (2008) theksoi që ofrimi i feedbackut efektiv është atëherë kur është i qartë dhe i jep nxënësve mënyra për të përmirësuar punën e tyre dhe për të zhvilluar më tutje ide për ta pasuruar detyrën. Informata kthyesë e mësuesit jep udhëzime për hapat e caktuar që nxënësit duhet marrë për të përmirësuar kuptimin e tyre ose të fokusohen në fushat kyçe për zhvillim dhe përparim. Me komentet e dhëna, mësuesi dallon përmirësimin dhe reflekton mbi punën e tij përmes informatës kthyesë. Ndërkaq, Brookhart (2016) pohon se nxënësit inkurajohen të përdorin vlerësimin e punës së tyre të mëparshme për të përmirësuar performancën e tyre të ardhshme duke i lidhur njohuritë dhe kuptimet e fakteve apo koncepteve. Të gjitha këto i pohon edhe Kurrikula Bërthamë (MASHt, 2016) duke treguar që informata kthyesë është komponentë e rëndësishme në vlerësimin ndaj nxënësve që ka për qëllim nxitjen dhe motivimin për të mësuar dhe për të përmirësuar të nxënësit e tyre.

2. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Përdorimi i vlerësimit formativ në krahasim me praktikat e tjera bazë të mësimdhënies mund të jenë mjaft sfiduese, dhe kjo mund të shërbejë si një shpjegim pse shumica e studimeve për vlerësimin formativ të kryer deri më sot janë të bazuara më shumë në diskutime teorike dhe jo në kërkime empirike. Nëse vlerësimi formativ me të vërtetë mbështet të mësuarit e nxënësve, është e rëndësishme që të demonstrojë në mënyrë empirike se e bën pikërisht atë, për të shmangur zhdukjen e saj. Për ta realizuar këtë, ne duhet të zhvillojmë një metodë për të matur përdorimin dhe strategjinë e saj në klasë (Ahmedi, 2019).

Bazuar në fokusin e studimit, në këtë punim janë përdorur paratesti dhe pastesti i grupit të kontrollit dhe grupit eksperimental. Grupi i kontrollit përfshijnë 25 nxënës të cilët nuk i nënshtrohen vlerësimit formativ dhe strategjisë së feedback-ut, kurse grupin eksperimental e përbëjnë 25 nxënës që vlerësohen në mënyrë formative dhe tek të cilët është përdorur strategjia e informatës kthyesë. (si ndërhyrje me fokus studimin). Pjesëmarrës në këto dy grupe janë 50 nxënës të klasave të pesta të shkollës fillore “Fan S Noli” në Kamenicë.

Te të dy grupet janë zhvilluar paratesti dhe pastesti i njëjtë nga ana e mësuesit. Te grupi i kontrollit mësuesi ka përdorur vlerësimin sumativ apo vlerësimin me notë, ku nxënësit kanë zgjidhur detyrat dhe janë përfshirë për të parë arritjet e tyre dhe atë se sa i kanë kuptuar mësimet e një kapitulli deri tani. Ndërkaq, te grupi eksperimental janë përdorur detyrat e testit të njëjtë por që mësuesi ka dhënë informatë kthyesë ndaj punës së tyre gjatë zgjidhjeve dhe përfshirjes në test. Nxënësit kanë qenë të lirë të pyesin mësuesin për hapat dhe punën e tyre gjatë zhvillimit të detyrave.

Testi i realizuar në këto dy grupe është test i lëndës së matematikës që përfshijnë 8 detyra me total të pikëve 100. Testi është ndërtuar në bazë të Taksonomisë së Bloom-it, pra me bazë të nivelit të njohjes. Gjithashtu, në bazë taksonomisë është bërë edhe ndarja e pikëzimit të detyrave në bazë të nivelit të njohjes.

Paratesti dhe pastesti ishte i njëjtë dhe është përdorur te të dy grupet. Te grupi i kontrollit, testi është përdorur dy herë (me një periudhë të caktuar kohore) pa ndërhyrje të strategjisë së feedback-it. Kurse, grupi eksperimental gjithashtu u janë nënshtuar testit dy herë, njëherit pa ndërhyrje të strategjisë së feedback-ut apo informatës kthyesë, kurse herën e dytë me ndërhyrje të strategjisë së informatës kthyesë apo feedback-ut.

3. REZULTATET

Në këto dy tabela shohim rezultatet e nxënësve të marra në të dy testet si dhe dallohet ndryshimi pas testit të dytë. Mësuesi gjatë realizimit të testit i ka njoftuar nxënësit me numrin e detyrave dhe totalin e pikëve si dhe kalueshmëria ka qenë mbi 50 pikë. Të gjithë nxënësit kanë arritur pikët e tyre dhe shihet se në testin 1 dhe 2 rezultati të shumica e nxënësve është i njëjtë. Dallojmë vetëm dy nxënës që kanë pasur përmirësim në testin e dytë +2 dhe +4 pikë dhe dy nxënës që kanë pasur rënie me nga -2 pikë. Nga këto rezultate të nxënësve të grupit të kontrollit mund të themi që në përgjithësi rezultatet janë të njëjta dhe pa ndryshime.

1. Tabela e rezultateve të grupit të kontrollit.

Nxënësi	Grupi	Testi 1	Testi 2	Rezultati (Ndryshimi)
1	Kontrollit	78	78	78
2	Kontrollit	76	78	+2
3	Kontrollit	60	60	60
4	Kontrollit	62	62	62
5	Kontrollit	62	62	62
6	Kontrollit	52	52	52
7	Kontrollit	90	88	-2
8	Kontrollit	88	86	-2
9	Kontrollit	78	78	78
10	Kontrollit	64	64	64
11	Kontrollit	62	62	62
12	Kontrollit	78	78	78
13	Kontrollit	78	78	78
14	Kontrollit	74	74	74
15	Kontrollit	82	86	+4
16	Kontrollit	84	84	84
17	Kontrollit	82	82	82
18	Kontrollit	82	82	82

19	Kontrollit	86	86	86
20	Kontrollit	58	58	58
21	Kontrollit	74	74	74
22	Kontrollit	74	74	74
23	Kontrollit	66	66	66
24	Kontrollit	76	76	76
25	Kontrollit	62	62	62

Ndërkaq, në tabelën e rezultateve të grupit të eksperimental dallojmë dukshëm ndryshimet e rezultateve pas ndërhyrjes së strategjisë së feedback-ut apo informatës kthyesë në testin e dytë. Ndryshimet e rezultateve kanë rrjedhur si pasojë e përdorimit të informatës kthyesë nga ana e mësuesit, i cili ka dhënë komente verbale apo me gjepte me qëllim të fokusimit dhe përmirësimit të punës së nxënësve, kështu duke i identifikuar ata vështirësitë e veta apo hapat e duhur të zgjidhjes së detyrave.

2. Tabela e rezultateve të grupit eksperimental.

Nxënësi	Grupi	Testimi 1 (para ndërhyrjes)	Testimi 2 (pas ndërhyrjes)	Ndryshimi (Rezultatet)
1	Eksperimental	82	86	+4
2	Eksperimental	84	88	+4
3	Eksperimental	78	80	+2
4	Eksperimental	92	100	+8
5	Eksperimental	64	70	+6
6	Eksperimental	88	90	+2
7	Eksperimental	75	80	+5
8	Eksperimental	75	80	+5
9	Eksperimental	90	92	+2
10	Eksperimental	84	86	+2
11	Eksperimental	84	86	+2
12	Eksperimental	76	80	+4
13	Eksperimental	60	60	0
14	Eksperimental	56	60	+4
15	Eksperimental	76	78	+2
16	Eksperimental	88	90	+2
17	Eksperimental	76	78	+2
18	Eksperimental	76	80	+4
19	Eksperimental	80	86	+6
20	Eksperimental	76	78	+2
21	Eksperimental	68	70	+2
22	Eksperimental	66	70	+4
23	Eksperimental	88	90	+2
24	Eksperimental	76	78	+2
25	Eksperimental	76	80	+4

4. ANALIZA E TË DHËNAVE

Nga tabela e rezultateve të grupit të kontrollit, pjesëmarrës në test kanë qenë 25 nxënës të klasës së pestë. Maksimumi i pikëve në test ka qenë 100 pikë. Në këtë grup të kontrollit, dallohet që të gjithë nxënësit kanë arritur notat e njëjta në test, përveç nxënësit 2, 7, 8 dhe 15 që kanë pasur ndryshime. Ndërkaq, shumica respektivisht kishin një vlerësim të barabartë me notën e tyre fillimisht të marra. Kjo tregon se në grupin e kontrollit, ku nuk është aplikuar strategjia e veçantë e informatës kthyesë, rezultatet kanë qëndruar konsistentë me fillimin e studimit. Nxënësit kanë shfaqur një nivel të performances në këtë test pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies.

Kurse, nga tabela e grupit eksperimental shohim se 25 nxënës janë pjesëmarrës në testin e realizuar në lëndën e matematikës. Mirëpo, ky grup i është nënshtruar dy herë testit, një herë pa ndërhyrje të informatës kthyesë, ndërsa në herën e dytë me ndërhyrje të strategjisë së feedback-ut apo informatës kthyesë. Nga tabela dallojmë ndryshimin e pikëve në total të marrë në herën e dytë dhe dallojmë që rezultatet janë më pozitive. Rezultatet tregojnë përmirësim të dukshëm në test pas zbatimit të strategjisë së informatës kthyesë. Shumica e nxënësve kanë treguar rritje të notave

nga testi 1 te testi 2. Rritjet ndryshojnë nga +2 deri në +8 pikë. Nxënësit 4, 5, 11, 12, 14, 15, 16, 18, 20, 21, 22, 24 dhe 25 kanë treguar përmirësim me +2 deri +4 pikë në testin e dytë, ndërsa nxënësit 1, 2, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 19 dhe 23 kanë treguar përmirësim më të shprehur me +4 pikë deri +8 pikë. Nxënësi 13 ka mbajtur të njëjtën note si në testin e parë (me 0 ndryshim), ndërsa nxënësit 3 dhe 14 kanë treguar një përmirësim të lehtë me +2 pikë.

Këto rezultate tregojnë se strategjia e feedback-ut apo informatës kthyeje ka ndikuar në përmirësimin e performancës së nxënësve të grupit eksperimental. Përmirësimi i notave pas ndërhyrjes tregon që nxënësit kanë marrë një reagim pozitiv dhe e kanë përdorur atë për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimore. Ky lloj ndikimi pozitiv në përmirësimin e performancës është një tregues i fuqisë dhe efikasitetit të strategjisë së informatës kthyeje në vlerësimin formativ të nxënësve në arsimin fillor.

5. KONKLUDIMET

Rezultatet nga tregojnë që vlerësimi formativ është vlerësim me ndikim pozitiv në rezultatet e arritura nga nxënësit si dhe strategjia e feedback-ut është një strategji tejet cilësore dhe e nevojshme e nxënësve. Kjo strategji ju ndihmon nxënësve dhe mësuesve të krijojnë një klimë pozitive dhe bashkëpunuese në klasë. Aty ku krijohet një klimë e mirë, aty nuk ka shqetësim nga nxënësit dhe ata ndjehen më të lirë në punët e tyre. Sipas të dhënave të marra në praktikë, dallojmë që nxënësit që u janë nënshtruar detyrave të testit me strategjinë e feedback-ut kanë rezultuar më të suksesshëm se sa nxënësit tek të cilët nuk është përdorur strategjia e feedback-ut. Nxënësit e grupit të kontrollit janë vlerësuar me notë si dhe kanë qenë më të shqetësuar për arritjet e tyre si dhe nuk ka pasur ndonjë komunikim të dyanshëm të mësuesit me nxënësit. Përkundër, grupit eksperimental ku mësuesi ka dhënë komente në mënyrë gojore apo me gjestikulacione gjatë komunikimit me nxënësit të cilët e kanë pyetur se a janë në rrugën e duhur të zgjidhjes së problemeve, apo kanë identifikuar vështirësitë e tyre dhe kanë kuptuar duke provuar se cilat janë rrugët e duhura për zgjidhjen e detyrave. Komponenti i informatës kthyeje ka për qëllim ngritjen e të nxënësve drejt arritjeve të rezultateve pozitive dhe këtë e mbështesin edhe planet dhe programet kurrikulare të arsimit parauniversitar.

FALEMNDERIMET

Ky punim u realizua falë bashkëpunimit me drejtorin e shkollës, mësuesit dhe nxënësit të cilët ndihmuan dhe kontribuan në mënyrë të dinjitetshme që punimi të jetë sa më cilësor. Një mirënjohje e thellë i dedikohet edhe profesoreshës së mësimdhënies së gjuhës angleze Dr. Donjetë Latifaj që në tërësi lektoroi punimin tonë.

REFERENCAT

- Ahmedi, V. (2019). Teachers' Attitudes and Practices Towards Formative Assessment in Primary Schools. *Journal of Social Studies Education Research*, 2019:10 (3), 161-175.
- Brookhart, S. (2016). *How to give effective feedback to your students*. Second Edition. Alexandria, Virginia. European Union for Kosovo (2020). Vlerësimi i nxënësve. Projekti "Zhvillimi profesional i Mësimdhënësve" Zbatuar nga: Planet, Sofreco dhe WUS Austria.
- Irons, A. (2008). *Enhancing Learning through Formative Assessment and Feedback*. Routledge: Taylor & Francis Group.
- Magbeyi, A., Calafiore, A., & Villamarin, A. (2020). *Purpose of Assessment. Creating positive classroom environments*. University of the People.
- MASHt (2011). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës*. Prishtinë.
- MASHt (2016). *Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës*. Prishtinë.
- OECD (2008). *Assessment for Learning Formative Assessment*. OECD-CERI International Conference "Learning in the 21st Century: Research, Innovation and Policy".
- Prashanti, E., & Ramnarayan, K. (2019). Ten maxims of formative assessment. *Advances in Physiology Education*, 43, 99-102.
- Wiliam, D. (2014). *The formative evaluation of teaching performance*. Centre for Strategic Education, September. <https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/feduc.2023.1101192/full>, 2023
- <https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0959475217302189>, 2023
- <https://www.jstor.org/stable/4624888>, 2023
- <https://archive.conscientiabeam.com/index.php/61/article/view/2842/5444>, 2023